


EDITORIAL

Funksionalizimi i Planifikimit

Funksionalizimi i Planifikimit është titulli i një libri të shkëlqyeshëm që u paraqit dhe u shpërnda në Forumin e Tretë Botëror Urban dhe Kongresin Botëror të Planifikimit në Vankuver në qershor të 2006-ës. "Making Planning Vvork" tregon se si zhvillimi dhe qeverisja e suksesshme e vendbanimeve njerëzore varet nga bashkëpunimi dhe themelimi i partneriteteve efektive, dhe sa mund të arrihet me punë të përbashkët, shkëmbim të aftësive, kreativitet dhe mësim duke punuar. Funksionalizimi i Planifikimit përmban raste të ndryshme studimi nga 20 vende të ndryshme, me fokus në planifikimin pro-varfërisë. Libri është literaturë thelbësore për të gjithë ata që janë të angazhuar në proceset e planifikimit dhe menaxhimit të qyteteve, qytezave dhe vendbanimeve, nga niveli i ultë lokal e deri në atë shtetëror e ndërkombëtar. Funksionalizimi i Planifikimit është burim frymëzimi për ta bërë të suksesshëm misionin tonë. "Hartimi i Planeve" – sidomos Planeve Zhvillimore Urbane e Komunale – është sigurisht i rëndësishëm, dhe është prioriteti ynë i parë. Por, një plan mund të jetë i



dobishëm vetëm nëse "funksionon" në praktikë. Jo vetëm si kornizë ligjore e kontrollimit të zhvillimit, por edhe si instrument aktiv për renditjen e veprimeve e intervenimeve urbane sipas përparësisë. Libri qartëson që planifikimi i veprimit nuk duhet të presë miratimin e gjitha planeve ligjore. Problemet urgjente kërkojnë intervenime urgjente, por sigurisht të ndërthurura brenda një vizioni strategjik. Në këtë buletin, ne jemi fokusuar mbi **Vendbanimet Joformale**, brenda fushëveprimit të gjerë të urbanizimit të egër pas konfliktit. Derisa komunat duhet të kenë një vizion për ato vendbanime joformale brenda zhvillimit të përgjithshëm të territorit të komunës, sfida e vërtetë është avancimi i vendbanimeve më të varfra dhe

problematike, kurdo dhe kudo që është e mundur. Pasi libri gjithashtu demonstroi që planifikimi mund të funksionojë vetëm me përfshirjen e vërtetë dhe direkte të palëve dhe qytetarëve, MuSPP-i ka inicuar një seri punëtorish "Vizionimi" në 6 qytetet sekondare, me përfshirje direkte të komuniteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile. Punëtorja e parë e Vizionimit për Mitrovicën me të vërtetë dëshmoi që qytetarët e "rëndomtë" nga etnitë e ndryshme janë në gjendje të shprehin një vizion të përbashkët dhe të fuqishëm me një spektër të plotë të veprimeve afatgjate e afatshkurte, dhe intervenimet urbane në përmirësimin e mjedisit jetësor për të gjithë qytetarët. Vetëm përmes kombinimit të vizionit dhe intervenimeve hapësinore mund të bëjmë planifikimin të funksionojë në Kosovë.

Frank D'hondt

Koordinator i MuSPP për Planifikim

Hapësinor,

Për më shumë

www.communityplanning.net/

makingplanningwork

Njohtim

Kemi kënaqësinë të iu njohtojmë që Programi i UN-HABITAT-it në Kosovë, MuSPP ka lansuar një faqe të re interneti, me domenin:

www.unhabitat-kosovo.org

Shpresojmë që kjo faqe interneti do të jetë instrument i dobishëm në komunikimet publike mbi programet, aktivitetet dhe organizimet e UN-HABITAT-it në lidhje me planifikimin dhe menaxhimin hapësinor dhe urban në Kosovë.



Përmbajtja

Vendbanimet joformale	
Rruga përpara.....	2
UN-HABITAT-i dhe	
Vendbanimet Joformale	2
Punëtorja	
"Bëjmë Mitrovicën më të mirë"	5
Punëtorja mbi avancimin dhe	
rregullimin urban të vendbanimeve	
joformale në Kosovë.....	9
Ferizaj takon Lundin.....	10

VENDBANIMET JOFORMALE – RRUGA PËRPARA

Vendbanimet joformale nuk janë gjë e re, dhe nuk janë vetëm në Kosovë. Komunat e Kosovës, si shumë vende tjera në Ballkan, ballafaqohen me sfida ligjore e fizike në rregullimin dhe avancimin e këtyre vendbanimeve duke krijuar kushte të qëndrueshme për jetesë.

Në shumë qytete të botës në zhvillim, gati gjysma e popullsisë jeton në vendbanime joformale që nuk janë të pranuar ligjërisht nga autoritetet e qyteteve. Derisa këto ndërtime mund të kuptohen si shenjë e rritjes ekonomike, zhvillimi i tyre i pakontrolluar vë një ngarkesë shtesë mbi buxhetet komunale. Në shumicën e rasteve, këto zona joformale të qyteteve nuk gëzojnë shumicën nga privilegjet e qasjes ndaj shërbimeve, e as zotërim të

sigurtë të pronës. Qeveritë rreth gjithë botës kanë të drejta zyrtarisht të pranuar universale ndaj banimit adekuat dhe standardeve jetësore. Megjithatë, realiteti nuk ofron këto standarde dhe qasjen ndaj titujve të sigurtë mbi pronën, e toka e banimi mbeten të vështira.

Zgjidhja e çështjes së vendbanimeve joformale është një nga prioritetet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Kjo është konfirmuar sërish me nënshkrimin e Deklaratës së Vjenës dhe është pasqyruar edhe në Planin e Përbushjes së Standardeve dhe Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian.

Punëtorja për Vendbanimet Joformale, organizuar bashkarisht nga MMPH, OSBE dhe UN-HABITAT më

16 nëntor 2006 nisi debatin mbi trajtimin e vendbanimeve ekzituese joformale, si dhe atë mbi parandalimin e lindjes së vendbanimeve të reja të tilla, duke ofruar disa përfundime dhe rekomandime për palët më të rëndësishme të përfshira në projekt.

Rekomandimet nga punëtorja u ndanë me pjesëmarrës tjerë të Takimit të Katërt të Shqyrtimit të Deklaratës së Vjenës, mbajtur në Beograd më 23 e 24 nëntor 2006, dhe u paraqitën publikisht në një konferencë shtypi, duke lansuar fushatën informuese mbi vendbanimet joformale.

MMPH-ja, UN-HABITAT-i dhe OSBE-ja planifikojnë të bashkëpunojnë në këtë çështje në të ardhmen, bashkë me partnerët tjerë.

UN-HABITAT-i DHE VENDBANIMET JOFORMALE

1. UN-HABITAT-i në Kosovë organizoi një punëtorja mbi "Avancimin dhe Rregullimin Urban të Vendbanimeve Joformale" më 16 nëntor 2006, bashkë me MMPH-në dhe OSBE-në.
2. Si kontribut për punëtorinë, UN-HABITAT/MuSPP ka përgatitur një dokument diskutimi të quajtur "Përmirësimi i Vendbanimeve Joformale". Ky dokument identifikon dispozitat ekzituese ligjore për trajtimin e çështjes së vendbanimeve joformale. Gjithashtu, hulumton modelet e mundshme për intervenime hapësinore në Vendbanimet Joformale.
3. Si vazhdimësi e punëtorisë, është përgatitur një dokument i përbashkët me rekomandime për Qeverinë e Kosovës, Komunat dhe banorët e vendbanimeve joformale.
4. Ky Dokument është vënë në dispozicion në formë të një broshure përmbledhëse, e cila është ende e mundur për shpërndarje të mëtejme.
5. Është themeluar një Grup Pune mbi Vendbanimet Joformale me MMPH-në, UN-HABITAT-in dhe OSBE-në si aktorë kryesorë. Synimi i tij është të organizojë punëtorja në terren dhe të ofrojë këshilla eksperte për avancimin dhe rregullimin e vendbanimeve jo-

Nocioni "Vendbanime Joformale" është definuar kështu nga Plani i Përbushjes së Standardeve të Kosovës: "Vendbanimet Joformale janë vendbanime njerëzore që nuk i mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përhershëm të jetesës, sidomos banimin e përshtatshëm. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të kenë karakteristikat si në vijim:

1. *Zotërim joformal ose i pasigurtë i pronësisë;*
2. *Qasje e papërshtatshme ose mungesë e qasjes ndaj shërbimeve themelore;*
3. *Pjesëmarrje joadekuate ose mungesë e pjesëmarrjes në qeverisje;*
4. *Ndjeshmëri deri në diskriminim."*

formale në praktikë.

6. Ekipet komunale të UN-HABITAT-it janë duke identifikuar vendbanimet joformale ekzituese në gjashtë qytetet sekondare në Kosovë. Kjo është e përbashkët me strategjinë e veprimit për integrimin e Vendbanimeve Joformale në vizionin e përgjithshëm hapësinor të komunave, si dhe për të renditur vepri-



met e intervenimet konkrete sipas përparësisë në avancimin e cilësisë hapësinore të Vendbanimeve Joformale.

Përkundër përqendrimit në avancimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale, prioriteti i parë i planifikimit të qëndrueshëm është ndalimi dhe shmangia e lindjes së vendbanimeve të reja joformale në Kosovë.

PËRMIRËSIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE

Eksperti ligjor i MuSPP-it ka përgatitur një dokument mbi **"Përmirësimin e Vendbanimeve Joformale"**, me qëllim të ofrimit të ndihmës për planerët dhe zyrtarët komunalë të urbanizmit e ekipet komunale të planifikimit, për të qartësuar dhe krijuar udhëzimet mbi rregullimin e vendbanimeve joformale në procesin e hartimit dhe miratimit të planeve zhvillimore komunale, planeve zhvillimore urbane, si dhe planeve rregullative urbane.

Tema e këtij dokumenti ishte vendbanimet joformale në përgjithësi, por dokumenti është përqendruar në një model rregullimi dhe konsolidimi të

vendbanimeve të tilla, i cili mund të merret parasysh në nivelin komunal. Dokumenti gjithashtu shikon kornizën institucionale dhe format e plotësimit të kërkesave të banorëve në komunë, në një zonë urbane, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi Vetë-Qeverisjen Komunale.

Në këtë dokument janë dhënë tri modele të mundshme të intervenimit në rregullimin e vendbanimeve joformale:

- **Përmirësimi i gjendjes ekzistues**
- **Rrënimi dhe rindërtimi, si dhe**
- **Rrënimi dhe zhvendosja,**

duke pasur gjithmonë parasysh synimet që duhen përmbushur me përmirësimin e kushteve mjedisore, sociale dhe ekonomike të banorëve. Ky dokument gjithashtu identifikon faktorët që duhen konsideruar gjatë planifikimit të intervenimeve urbane me mbështetjen e komunitetit, si: shkalla e problemit, pronësia, pjesëmarrja, struktura financiare, etj.

Dokumenti ofron edhe informata mbi tipologjinë e projekteve në përmirësimin dhe legalizimin urban të vendbanimeve njerëzore dhe përfshin edhe udhëzime mbi menaxhimin e projektit dhe fazat e ciklit të projektit.

KËNDI I KOMUNAVE

PUNËTORIA E SHOQËRISË CIVILE NË FERIZAJ

Komuna e Ferizajt dhe Programi MuSPP i UN-HABITAT-it organizuan një punëtori, si pjesë e aktiviteteve dedikuara për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e planifikimit në komunat e Kosovës. Punëtorja u mbajt më 12 dhjetor 2006, dhe u ndjek nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunës, përfaqësues të MuSPP-it dhe mediave lokale.

Gjatë punëtorisë, pjesëmarrësit patën mundësi të mësojnë më shumë mbi zhvillimin strategjik e përfshirës lokal, si dhe patën mundësi të shprehin brengat e tyre në lidhje me përfshirjen e tyre në proceset e planifikimit dhe menaxhimit. Brengat kryesore të ngritura në këtë takim qenë: ndërtimet e paligjshme, zhvillimi lokal ekonomik, përfshirja e qytetarëve në demokratizimin e shoqërisë civile, si dhe fuqizimi i femrave në vendim-marrje. Pjesëmarrësit gjithashtu ngritën brengën për mungesën e organizatave të shoqërisë civile që do të merreshin me planifikimin hapësinor dhe çështjet mjedisore në komunën e tyre. Ky aktivitet u vazhduar me një punëtori tjetër të mbajtur më 30 janar, në të njëjtin vend, me të njëjtit njerëz. Këtë herë, diskutimet u orientu-



an kah brengat e përfshirjes së shoqërisë civile në zgjidhjen e brengave të ngritura, si: gurthyesi në zonën e Nerodimes; zhvillimi ekonomik – hekurudha në mes të qytetit; përmirësimi i furnizimit me energji elektrike; zhvillimi i bizneseve prodhuese dhe ndërtimi i ndërtesave për banim dhe tregti në tokë ndërtimore, ku nuk ka plane zhvillimore. Kjo punëtori rezultoi përfundimisht me themelimin e një këshilli jofor-

mal që përbëhet nga 7 pjesëmarrës nga Organizatat e Shoqërisë Civile dhe qytetarë të përkushtuar për të kontribuar drejt një qeverisjeje më të mirë urbane në Ferizaj. Përderisa ky buletin është përgatitur për shtyp, 30 përfaqësues të komunës dhe shoqërisë civile morën pjesë në një takim punues në Ohër. Në numrin tjetër do të informoheni më shumë për këtë ngjarje


PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE URBAN I PEJËS

Komuna e Peës është një nga komunat e para që ka hartuar Planin Zhvillimor Komunal, që është në pajtim me procedurën e miratimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHU). Komuna aktualisht është në pritje të pëlqimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) mbi miratimin e PZHK-së. PZHK-ja është vlerësuar në krahasim me Planin Hapësinor të Kosovës për të siguruar përputhjen, e cila duhet të kishte qenë e mirë, përveç disa vërejtjeve dhe propozimeve të vogla nga MMPH-ja. Këto janë trajtuar nga Drejtorati për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban e Rural dhe Mjedis (DPZHURM), ndërsa dokumenti i shqyrtuar është paraqitur sërish për pëlqim.

Pas pëlqimit nga MMPH-ja, të dyja planet do t'i paraqiten Kuvendit të Komunës (KK) të Pejës për miratim përfundimtar. Ky vendim pritet të bëhet në takimin e parë të KK të Pejës në shkurt.

Pas miratimit të planeve, Komuna do të angazhohet në implementimin e tij, duke filluar me procesin e hartimit të Planeve Rregullative Urbane (PRrU).

Aktualisht, Ekipi Komunal i Plani-



fikimit (EKP) është ri-themeluar dhe po mban takime të rregullta dy-javore. Në secilin nga takimet e tij, ngriten çështje të ndryshme që pastaj trajtohen në grupet gjegjëse punuese:

- Hartimi i politikës së mobilitetit (lëvizshmërisë)

- Hartimi i politikave hapësinore-bujqësore
- Strategjia e komunikimit dhe informimit
- Centralizimi i informatave hapësinore
- Planifikimi rregullativ urban

Në bashkëpunim me drejtoratet gjegjëse të administratës komunale dhe Programin e UN-HABITAT-it për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP), DPZHURM-a është duke hartuar hartën e rrugës për fazën e parë të implementimit të PZHK-së dhe PZHU-së. Deri tani, janë identifikuar gjashtë synime prioritare, bashkë me veprimet e definuara dhe rezultatet e pritura. Harta pritet të miratohet në takimin e ardhshëm të Bordit të Drejtorëve. Aktiviteti i parë do të jetë planifikimi rregullativ urban, me vendbanimet njerëzore kuptuara si prioriteti më i lartë, derisa planet tjera rregullative renditen sipas prioritetit.

Merita Kuraja

Urbaniste, Drejtorati për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban dhe Rural dhe Mjedis në Pejë

ZHVILLIMI I ZONËS SË RE INDUSTRIALE NË PEJË

Të martën, më 6 shkurt, Ekipi i MuSPP-it në Pejë, organizoi një punëtori mbi zhvillimin e zonës së re industriale në qytet. Seanca tërhoqi një pjesëmarrje të madhe nga zyrtarët e MMPH-së, përfaqësues të nivelit qendror të IPVQ-ve, AKM-së, zyrtarë të planifikimit komunal nga pjesë tjera të Kosovës, si dhe shumë partnerë tjerë të përfshirë në përpjekjet e planifikimit hapësinor në Pejë. Prezantimi i përbashkët i bërë nga Komuna dhe UN-HABITAT-i ofroi detajet e propozimit për zonën industriale, duke qenë në pajtim me politikën zhvillimore të shfrytëzuar në Planin Zhvillimor Komunal. Karakteristikat kryesore të prezantimit ishin nevoja për

një zonë moderne dhe funksionale industriale, e cila është brenda dhe ka qasje të mirë ndaj zonës urbane, ka pozitë strategjike në kuptimin e infrastrukturës, dhe përfundimisht ofron një mundësi të mirë për zhvillimin afarisht dhe krijimin e punësimit. Propozimi i rekomandit Komunal të themelohet një Agjenci Zhvillimore Komonale, e cila do të shtynte përpara këtë projekt, dhe në bazë të suksesit të tij, do të vazhdonte tutje me zhvillimet e ardhme të zonës industriale. Shumica e pjesëmarrësve shprehën përkushtimin e tyre të sinqertë për kontribim në realizimin e këtij plani, mbi të cilin do të organizohen konsultime të mëtejme në të ardhmen e

afërt. Organizatorët gjithashtu priten të shpërndajnë konkludimet dhe rekomandimet që dalin nga kjo punëtori. Iniciativa u përshendet për rëndësinë e saj për zhvillimin ekonomik nga të gjithë partnerët, dhe sidomos nga Kryetari i Kuvendit Komunal, i cili bëri fjalimin hyrës. Një brengë e cila u theksua gjatë kësaj seance ishte e lidhur me çështjet pronësore, pasi zona e identifikuar për zhvillim është pjesërisht private, dhe ngrit procedura të komplikuar, të cilat mund të ndikojnë në periudhën e zbatimit të projektit.

Në bazë të Raportit Ditor nga UNMIK-u Pejë, 6 shkurt 2007

SHOQËRIA CIVILE DËSHIRON TË LUAJË ROL MË TË MADH NË ZHVILLIMIN LOKAL NË PRIZREN

Më 12 dhjetor 2006, punëtorja mbi "Zhvillimin Përfshirës Strategjik Lokal" u mbajt në Prizren. Punëtorja u organizua nga Komuna e Prizrenit dhe UN HABITAT- MuSPP, ndërsa pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e Komunës, shoqëria civile dhe qytetarë tjerë.

Pjesëmarrësit e kësaj punëtorie patën mundësinë e shkëmbimit të qëndrimeve të tyre mbi temat si bujqësia, trashëgimia kulturore dhe planifikimi urban.

Sa i përket angazhimit të shoqërisë civile në procesin e planifikimit lokal, pjesëmarrësit qartësuan që shoqëria civile në Prizren nuk është aq mirë e organizuar. Kështu, u rekomandua fuqimisht që shoqëria civile duhet të jetë shumë më aktive, por edhe që Komuna duhet të investojë më shumë në përfshirjen e shoqërisë civile në planifikimin dhe zhvillimin urban të Prizrenit.

Punëtorja ishte vazhdimësi e takimeve

të mëhershme, ku ishte vendosur të krijohej një këshill joformal, të përbërë nga profesionistë dhe anëtarë të pavarur nga organizatat e shoqërisë civile. Këshilli do të funksionojë si urë lidhëse mes Komunës dhe Shoqërisë Civile në lidhje me zhvillimin dhe planifikimin strategjik urban.

Në fund të punëtorisë, pjesëmarrësit shprehën interesimin e tyre për të vazhduar me punëtori të ngjashme.

PUNËTORIA "BËJMË MITROVICËN MË TË MIRË"

Nga 11 e deri më 15 janar, u mbajt një punëtori kreative dhe intensive në Shkup, IRJ të Maqedonisë, duke përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatat mediatike, planerët profesionalë dhe qytetarët e Mitrovicës së Jugut dhe Veriut, si dhe anëtarët e personelit nga UN-HABITAT-i në hulumtimin e çështjeve dhe ideve për përmirësimin e mjedisit jetësor në Mitrovicë.

Punëtorja u organizua nga UN-HABITAT-i në Kosovë në bashkëpunim me Qendrën e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, Radio Kontakt Plusin, Community Building Mitrovica dhe Radio-TV Mitrovicën. Pjesëmarrësit u mobilizuan nga shoqëria civile dhe organizatat mediatike bashkë-organizatore. Punëtorja u ndihmua me përzemërsi nga OSBE-ja (që siguroi transportin për pjesëmarrës), Friedrich Ebert Stiftung ndihmoi në moderimin e punëtorisë, si dhe Qendra Maqedone për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (paraqitja përfundimtare e rezultateve).

Qëllimi ishte të hulumtohej, në një atmosferë të relaksuar, çështjet dhe veprimet e mundshme të përmirësimit të cilësisë së mjedisit jetësor për gjithë qytetarët e Mitrovicës. Kriza aktuale ekonomike dhe cilësia e dobët e jetës që përjetohet nga të dyja pjesët e qytetit (veri e



jug) ishte pikë fillestare e ushtrimit të diskutimit dhe dialogut mes dy komuniteteve. Në shprehjen e brengave dhe preferencave të tyre, njerëzit nga të dyja pjesët e qytetit identifikuan çështjet e përbashkëta dhe punuan bashkë në zhvillimin e zgjidhjeve që ofrojnë përfitime për të gjithë.

Punëtorja angazhoi dhe fuqizoi shoqërinë civile dhe organizatat civile në Mitrovicën e Jugut dhe Veriut. Gjithashtu, përforcoi dialogun dhe bashkëpunimin mes organizatave të shoqërisë civile dhe planerëve profesionistë nga Mitrovica e Veriut dhe Jugut. Me anë të metodës së Multi-Vizionimit, gjitha idetë e mundshme u hulumtuan në mënyrë shumë kreative. Multi-vizionimi i mjedisit jetësor të Mitrovicës nënkupton që

secili është i lirë në shprehjen e vizionit dhe ideve të tij, pa pasur nevojën e integritimit të ideve në një vizion të vetëm. Edhe pse kjo qasje lejon vizione të ndryshme për Veriun dhe Jugut, synimi ishte diskutimi i hapur i elementeve të përbashkëta dhe konfliktuozë të vizioneve dhe ideve të elaboruara, duke dalur përfundimisht me një Deklaratë të përbashkët të Vizionit për zhvillimin e ardhshëm të Mitrovicës në afatin e shkurtë (2012) dhe atë të gjatë (2022). Ann-Sofie Nilsson (SIDA/Zyra Suedeze) dhe Alastair Butchart-Livingston (Zyra Rajonale e OSBE-së në Mitrovicë) ndoqën prezentimin e rezultateve dhe shprehën shpresën e tyre që kjo iniciativë do të ketë vazhdimësi dhe zbatim të projekteve konkrete në të ardhmen e afërt.

PUNËTORIA LEGJISLATIVE NË GJILAN

Më 16 janar 2007, u mbajt një punëtori e inicuar nga Drejtorati për Shërbime Publike dhe Ndërmarrje i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, si dhe Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP). Këshilltari ligjor i UN-HABITAT-it, Z. Lazim Salihu, prezantoi një vështrim mbi Ligjin mbi Transportin Rrugor, Ligjin mbi Rrugët, si dhe Ligjin mbi Mbeturinën, për zyrtarët komunalë nga departamente të ndryshme të Komunës.

Synimi primar i punëtorisë ishte rritja e kapacitetit dhe njohurisë profesionale të zyrtarëve komunalë në lidhje me këto ligje, por edhe diskutimi i ndërlidhjes së tyre me planifikimin hapësinor dhe urban. Gjatë prezantimeve, u ofruan edhe shpjegime tjera në aspektin e përgjegjësisë komunale

në trajtimin e lëndëve të rregulluara me ligjet e lartpërmendura.

Disa pengesa të përmendura gjatë debatit ishin që ligjet duhen bashkërenduar dhe harmonizuar, si dhe që komunat janë të kufizuara në autoritetin e tyre në zbatimin e këtyre ligjeve. U theksua që këto çështje nuk duhet të pengojnë komunat në ndërmarrjen e aktiviteteve në rregullimin e çështjeve publike në komuna. Folësit kërkuan gjithahtu mbështetje nga ministritë gjegjëse në interpretimin e ligjeve për komunat, në krijimin e fakteve zyrtare me ndihmën e Sistemeve Informative Gjeografike (GIS), në identifikimin e normave dhe standardeve për zbatimin e këtyre ligjeve në pajtim me Direktivat e BE-së, etj.

U arrit një pajtueshmëri e fuqishme që takime e punëtori të ngjashme të cilat ndihmojnë në interpretimin e ligjeve tjera, sidomos në ndërlidhje me planifikimin hapësinor, janë shumë të mirëpritura.

Është e rëndësishme që në bazë të vlerësimit të punëtorisë të bërë përfundimisht nga pjesëmarrësit, mund të konkludohet që punëtorja ishte e përgatitur mirë, në aspektet teknike dhe substanciale, derisa theksohet në mënyrë specifike përgatitja e ligjëruesit dhe mënyra e prezantimit.

Agim Salihu

Drejtor i Drejtoratit për Ndërmarrje dhe Shërbime Publike në Komunën e Gjilanit

SHQYRTIMI PUBLIK I PLANIT RREGULLATIV URBAN PËR VENDBANIMIN JOFORMAL TË BREKOCIT - GJAKOVË



Komuna e Gjakovës ka identifikuar Brekocin si vendbanim joformal, dhe kështu ka përgatitur një plan rregullativ urban për rregullimin e tij. Më 22 dhjetor 2006, Drejtorati i Urbanizmit në Komunën e Gjakovës organizoi një shqyrtim publik të planit. Kjo u bë në restorantin fqinj të quajtur "Florida". Shqyrtimi publik i planit u parapri me aktivitete informuese përmes Zyrës së Informimit. Për shkak të festave dhe niveleve të ulta të pjesëmarrjes së anëtarëve të komunitetit, shqyrtimi publik u mbajt i hapur më gjatë

sesa që kërkohej me ligj. Gjatë kësaj periudhe, Komuna, bashkë me përfaqësuesit e komunitetit dhe kompanisë hartuese (Urban +), organizoi një debat dy-ditor të mbajtur më 23 dhe 24 janar. Debatu u mbajt si i ndarë për blloqe urbane. Gjatë këtij debati, plani u shpjegua në detaje, dhe u dha mundësia për përfaqësuesit nga sektori urban komunal dhe komunitetit që të japin vërejtjet dhe propozimet e tyre në lidhje me planin. Këto pastaj iu dërguan kompanisë për shqyrtim dhe inkorporim brenda planit, aty ku

është e arsyeshme.

Pas shqyrtimit, plani do të diskutohet nga Këshilli i Ekspertëve të Planifikimit, Bordi i Drejtorëve, si dhe Komiteti i Urbanizmit, pastaj t'i paraqitet Komitetit për Politika e Financa, e pastaj edhe t'i dorëzohet Kuvendit Komunal për miratim formal.

Bazuar në raportin mbi shqyrtimin publik të Planit Rregullativ Urban të vendbanimit joformal të Brekocit, përgatitur nga Znj. Nesrete Ajroni/ DU, KK Gjakovë

KËNDI i UN-HABITAT-it

PLANI AFATMESËM STRATEGJIK DHE INSTITUCIONAL I UN-HABITAT-IT PËR 2008-2013

Të mërkurën, më 19 dhjetor, Nicholas You, Këshiltar Special për Politika dhe Planifikim Strategjik nga Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, vizitoi personelin e UN-HABITAT-it në Kosovë. Synimi i vizitës ishte prezantimi i projekt-Planit Afatmesëm Strategjik dhe Institucional (MTSIP) për periudhën 2008-2013 për UN-HABITAT-in. Ky plan është reagim ndaj çështjeve komplekse që përjetojnë nga vend-

banimet njerëzore, sidomos në ato të varfra me rritje të shpejtë, të cilat nëse nuk trajtohen mund të bëhen shkak i jostabilitetit, duke dëmtuar qeniet njerëzore dhe mjedisin natyror. MTSIP-ja gjashtë-vjeçar është levë për vizionin e qyteteve të jetueshme, produktive dhe përfshirëse të siguruara me urbanizimin e qëndrueshëm. Ai pranon që urbanizimi i qëndrueshëm kërkon një hartë

rrugore të mbështetur nga pjesëmarrësit. Nga fillimi, UN-HABITAT-i ka kuptuar që për të qenë katalizator i vërtetë, procesi duhet të jetë pjesëmarrës. MTSIP fton për ndërtim të vazhdueshëm dhe të rritur të aleancave me ata që janë të përkushtuar të sigurojnë ndryshimin – Partnerët e Agjendës së Habitatit. Prezantimi i MTSIP-së u ndoq me një diskutim interaktiv.

PLANERËT E UNIVERSITETIT TË LEUVENIT VIZITOJNË BALLKANIN

Andre Loecx dhe Jef van den Broeck janë të dy profesorë të planifikimit hapësinor dhe dizajnit urban në universitetin e Leuvenit (Belgjikë). Mes 23 dhe 29 nëntorit të vitit të kaluar, ata vizituan rajonin e Ballkanit, për të identifikuar rastet sfiduese me kërkimin që të themelojnë një seminar rajonal të dizajnit dhe planifikimit urban në bashkëpunim me Selinë e UN-HABITAT-it. Gjatë udhëtimit të tyre të shkurtër në Ballkan, ata gjithashtu identifikuan vende specifike për një shkallë Master në dizajn urban.

Ekipi i MuSPP-it në Kosovë organizoi një program të shkurtër, por intensiv, për të njoftuar profesorët me Kosovën dhe sfidat e planifikimit në të. Të dielën në mëngjes (26 nëntor), një delegacion i MuSPP-it përcolli dy profesorët nga Shkupi për në Ferizaj, me tren! Treni, si zakonisht, arriti në kohën e caktuar dhe dele-



gacioni u mirëprit nga përfaqësuesit nga Komuna e Ferizajt. Ata dhanë një prezantim mbi përparimin e planifikimit në përgjithësi dhe planin e veprimit për Qendrën e Mobilitetit në veçanti. Vizita në terren e bëri të qartë që ka shumë për të bërë për të kthyer ëndrrën në realitet. Një ushtrim i dizajnit urban sigurisht që do të kontribuonte për tejkalimin e kësaj rruge. Pas drekës, profesorët u dërguan në Gjilan, ku ata vizituan dy vende specifike: Lumin *Mirusha* në qendrën e qytetit dhe vendbani-

min joformal *Zabeli I Sahit Agës* në skaj të qytetit. Dy vizitat qartësuan që komuna po kërkon metoda të planifikimit me përfshirjen e duhur të pjesëmarrësve dhe qytetarëve. Të hënën, dy profesorët prezantuan misionin e tyre në Zyrën e UN-HABITAT-it në Prishtinë. Duke iu falënderuar prezencës së përfaqësuesve të Departamentit dhe Institutit të Planifikimit Hapësinor, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Universitetit të Prishtinës/Fakultetit të Arkitekturës, u bë një debat i gjallë mbi sfidat e planifikimit dhe rolin e dizajnit urban si vegël për arritjen e "pakteve urbane" mes gjithë pjesëmarrësve gjegjësisht, përmes procesit të "urbanizimit të negociuar".

Më vonë këtë vit, dy profesorët do të paraqesin raportin dhe rekomandimet e tyre mbi atë se ku dhe kur do të mbahen Seminari i Ballkanit dhe aktivitetet në terren.

UN-HABITAT-I NI KOQIR I GJYKATËS SË FEMRAVE TË FORUMIT BOTËROR SOCIAL

Nairobi 22/01/2007- Qindra delegate të Forumit Botëror Social që po mbahet në Najrobi, Keni, u bashkuan në Selinë e UN-HABITAT-it për një seancë speciale për të theksuar telashet që gratë kanë në gjithë botën.

E njohur si "Gjykata Botërore e Gruas mbi Varfërinë: jetët, jetesa, bota e jetës", seanca dëgjoi dëshmitë e grave në ven-

det në zhvillim mbi problemet e varfërisë, dhimbjes, mbijetesës dhe rezistencës ndaj shkaqeve strukturale të varfërisë dhe skamjes. Dëshmitë u pranuan nga një juri e grave dhe meshkujve të mençur nga gjitha pjesët e botës.

Në një fjalim për pjesëmarrësit, Drejtoresha Ekzekutive e UN-HABITAT-it, Znj. Anna Tibaijuka tha që Forumi

Botëror Social 2007 po mbahej në një kohë kritike në historinë njerëzore, kur gjysma e popullsisë botërore do të jetojë në zona urbane.

Znj. Tibaijuka sfidoi pjesëmarrësit të çmojnë problemin e vendbanimeve të varfra dhe vështirësitë që ata banorë të varfër kanë kaluar.

Burimi: www.unhabitat.org

KËNDI I MEDIAVE

Në këndin e Mediave kemi zgjedhur disa tituj e citime interesante në lidhje me planifikimin urban dhe zhvillimet në Kosovë. Artikujt origjinal mund t'ju dërgohen sipas kërkesës.

Synohet avancimi i çështjes së vendbanimeve joformale

Ky artikull ofron informata mbi punëtorin në mbi vendbanimet joformale, organizuar nga MMPH, UN-HABITAT dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë. Me moton "Për një jetë më të mirë në Komunën time", punëtorja synonte ngritjen e vetëdijes mbi avancimin dhe rregullimin urban të vendbanimeve joformale dhe ndërtimin e strategjive për zgjidhjen e çështjeve, në frymën e Deklaratës së Vjenës dhe Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian.

Burimi: Zëri, 17/11/06

PRISHTINA

Kryeqytet me shtatë mijë objekte ilegale

Për herë të parë pas luftës në Kuvendin Komunal të Prishtinës të mërkurën do të diskutohet për ndërtimet pa leje. Me gjithë kërkesat e kuvendarëve të Prishtinës, që kjo çështje të diskutohet si pikë e veçantë, udhëheqja komunale ka vendosur që për këtë problem të diskutohet vetëm në bazë të një informate të përgatitur nga drejtorja e inspeksionit. Nga inspeksioni është bërë e ditur se janë rreth 7 mijë objekte pa leje në kryeqytet.

Burimi: Lajm, 12/02/2007

GJAKOVA

Gjakova, më 2015, me 5 qendra urbane dhe me hekurudhë

Artikulli ofron informata mbi përbajtjen e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban të Gjakovës, që është në proces. Me Planin Zhvillimor, Gjakova planifikon të ketë 5 qendra lokale, urbane dhe administrative që do të ndërtohen në pesë fshatrat më të mëdha. Krijimi i këtyre qendrave do të parandalonte migrimet e popullsisë drejt qendrës.

Siç u theksua nga Kryetari i KK Aqif Shehu, orientimi i zhvillimit komunal dhe urban duhet drejtuar kah Malësia e Gjakovës, me synim që edhe Shqipëria Veriore të përfitojë nga zhvillimi, si Trovoja, Bajram Curri, etj.

Burimi: Koha Ditore, 13/12/06

GJILAN

Nuk ka zhvillime të reja me plane të vjetra

Duke ditur që planifikimi i mirë hapësinor paraqet një interes kapital për të sotmen dhe gjeneratat që do të vijnë, komuna e Gjilanit ka filluar punën në hartimin e PZHK/PZHU. Sevdije Maliqi, Drejtoreshë e Urbanizmit, Rindërtimit dhe Mjedisit, theksoi që Gjilani ka shumë nevojë për këto plane, për të reaguar nga kërkesave të qytetarëve në mënyrë të qëndrueshme. Në këtë kuptim, janë mbajtur shumë debate me qytetarë dhe grupe interesi, derisa drafti përfundimtar i planeve do t'i nënshtrohet shqyrtimit publik. Në disa debate në të kaluarën, është theksuar që gjeneratat do të jetojnë me trashëgiminë e lënë nga planifikimi i sotëm, qoftë ai i mirë apo i dobët.

Burimi: Infopress, 06/09/06

MITROVICA

Aksion për lehtësimin e qarkullimit

Komuna e Mitrovicës ka ndërmarrë një aksion për lehtësimin e qarkullimit të lirë të qytetarëve dhe automjeteve, duke eliminuar pengesat fizike nëpër rrugë dhe trotuare. Drejtori për Inspeksion, Ismet Sylja, njoftoi se një grup i formuar për këtë qëllim është duke përcjellë qarkullimin e autotaksive, kombibusëve dhe autobusëve, për të konstatuar se a është veprimtaria e tyre legale apo ilegale, dhe për të përcaktuar vendpërkëmbjet adekuate.

Burimi: Lajm, 09/02/2007

PEJA

Amfiteatër në shtrojerën e kafshëve të egra

Artikulli ofron një vështrim interesant mbi një projekt (amfiteatri në fshatin Drelaj në Rugovë), investitori është biznesmen nga Rugova, që aktualisht jeton në Danimarkë. Projekti është paraparë të investojë të paktën 1 milion euro për veprën artistike që është e parë e këtij lloji në Kosovë. Me ngrehinën e nisur në vendlindje, i është mbushur mendja që mund të ndryshojë mentalitetin shoqëror. Sipas bashkëpunëtores së projektit, Violeta Ukaj, amfiteatri do të jetë në funksion të fisnikërimin të njerëzve.

Burimi: Koha Ditore, 12/12/06

PRIZREN

Sfida të shumta për urbanizmin dhe planifikimin hapësinor

Sfidat në urbanizëm dhe planifikimin hapësinor në komunën e Prizrenit janë të shumta, dhe do të jenë të vështira të tejkalohen me kushtet e tanishme. Mungesa e regjistrimit të popullsisë, mungesa e orto-fotove kadastrale janë vetëm disa nga elementet për hartuesit që po mundohen të vënë rregull në këtë fushë.

Gjitha këto deklarata u bënë nga ekspertët e fushave të caktuara, në një takim të "Klubit të Debatit", organizuar në Prizren nga OJQ-ja "FID".

Sipas Drejtoratit të urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në KK Prizren, Refki Muzbeg, Prizreni nuk ka Plan Zhvillimor Urban, që do të ishte themeli i hartimit të planeve të tyre. Megjithatë, janë bërë hapa pozitivë në këtë drejtim, sepse bashkë me UN-HABITAT-in, hartimi i atyre planeve tanimë ka filluar.

Source: Koha Ditore 04/01/2007

FERIZAJ

Disenjohet komunikacioni sipas normave

Ky artikull thekson vështrime të rëndësishme mbi trafikun urban në Ferizaj. Ferizaj, si qytet i ri, është i hendiëkuar me rrjetin rrugor. Duke marrë parasysh vëllimin ditor të qarkullimit, si dhe duke ditur që është bosht rajonal i trafikut, rregullat e transportit të mallrave dhe udhëtarëve duhen kuptuar si më të rëndësishmet. Pushteti lokal tashmë ka sjellë një projekt rregullor, e cila ripërcakton shumë kriterë, duke filluar që nga relacionet e udhëtimit në rrugë të caktuara, stacionet lokale për udhëtarët lokalë, themelimin e regjistrimit dhe inspektimit, transportin e udhëtarëve dhe bagazhit, sinjalizimin e trafikut, stacionet lokale të jashtme të autobusit, kushtet e vendosjes së reklamave, etj. Diskutimi publik do të pasurojë këtë rregullorë, OJQ-të kanë ftuar qytetarët për disa ditë, ata dhe grupet e interesit, që të marrin pjesë në këtë debat për diskutimin e draft-rregullores.

Burimi: Koha ditore 19.12.2006

RRJETËZIMI

PUNËTORIA MBI AVANCIMIN DHE RREGULLIMIN URBAN TË VENDBANIMEVE JOFORMALE NË KOSOVË

Më 16 nëntor 2006, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, UN-HABITAT-i dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë organizuan një Punëtori të përbashkët mbi Avancimin dhe Rregullimin Urban të Vendbanimeve Joformale në Kosovë.

Qëllimi i punëtorisë ishte ngritja e vetëdijes mbi avancimin dhe rregullimin urban të vendbanimeve joformale si dhe ndërtimi i strategjive për zgjidhjen e çështjes në frymën e Deklaratës së Vjenës mbi Vendbanimet Joformale, Planin për Zbatimin e Standardeve të Kosovës (PZSK) dhe Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian (PVPE). Iniciativa ka rrjedhur si përgjigje ndaj gjendjes aktuale në Kosovë dhe zhvillimin e shpejtë të zonave peri-urbane. Gjatë dekadave të fundit, e sidomos pas konfliktit, Kosova



ka parë zhvillimin e vendbanimeve joformale brenda dhe rreth qyteteve të saj.

Duke përafuar partnerë të ndryshëm bashkë, përfaqësuesit e organeve qendrore e lokale, ekspertët ndërkombëtarë e vendorë të ligjit urban, politikave dhe

rregullimin e vendbanimeve joformale, përfaqësues të OJQ-ve lokale e rajonale, përfaqësues të Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal nga UN-HABITAT-i dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë, punëtorja ofroi një mundësi të diskutimit të çështjeve të ndryshme të integritimit të vendbanimeve joformale në planet hapësinore komunale dhe planet urbane dhe të zhvillimit të ideve për t'u marrë me këto sfida në të ardhmen.

Në vazhdimësi me këtë aktivitet, më 12 dhjetor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, UN-HABITAT-i dhe OSBE-ja organizuan një konferencë shtypi dhe publikuan rekomandimet publike mbi rregullimin e vendbanimeve joformale dhe avancimin e zonave urbane.

TAKIMI I KATËRT RAJONAL PËR SHQYRTIMIN E DEKLARATËS SË VJENËS

Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Vjenës për Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore (EJL); Kosova ka rikonfirmuar përkushtimin e saj për të formalizuar vendbanimet ekzistuese joformale dhe parandalimin e zhvillimeve të ardhme të banimit joformal. Në konferencën ministrore të EJL të mbajtur në shtator të vitit 2004, është identifikuar interesi jetik i qeverive të EJL dhe institucioneve ndërkombëtare për të ndërtuar një instrument të ndërtimit të kapaciteteve për trajnimin e zyrtarëve shtetërorë dhe komunalë në fushën e menaxhimit urban dhe banimit. Është ndërtuar Programi Rajonal i Përforsimit të Kapaciteteve (RCSP). Për zbatimin e këtij programi, janë mbajtur disa Takime Shqyrtuese për Deklaratën e Vjenës dhe punëtori teknike mbi banimin dhe menaxhimin urban.

Takimi i katërt rajonal i Shqyrtimit të Deklaratës së Vjenës u mbajt më 23 dhe 24 nëntor në Beograd, Serbi. Kosova u përfaqësua nga Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Bashkëpunimit Ndërkomunal, i cili

funksionon brenda Departamentit të Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Krystyna Galezia, Zyrtare Kryesuese e UN-HABITAT-it në Kosovë.

Pjesëmarrësit nga vendet tjera të EJL-së vinin nga Shqipëria, Bosnia e Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kroacia dhe Serbia, si dhe përfaqësues të OJQ-ve të ndryshme vendore e ndërkombëtare, si dhe agjencitë mbështetëse që morën pjesë. Takimi synonte sigurimin e vazhdimësisë në trajtimin e çështjeve të vendbanimeve joformale përgjatë gjithë rajonit duke:

- Diskutuar statusin e përgatitjes së RCSP-së dhe implementimit fillestar, sidomos në shqyrtimin e procesin e përzgjedhjes së pilot/demo-projekteve si dhe diskutimin e dy propozimeve të zgjedhura nga Shqipëria dhe Mali i Zi.
- Shqyrtuar çështjet që dalin me zbatimin e Planeve të Veprimit të Deklaratës së Vjenës, si dhe
- Mësuar nga përvojat operationale në trajtimin e çështjes së vend-

banimeve joformale, në bazë të vizitës në terren, si dhe prezencës së projekteve në Serbi.

Pas paraqitjes së përparimit të planeve të veprimit në vendet e tyre, përfaqësuesit e Ministrive nënshkruese të Deklaratës së Vjenës ngritën dhe diskutuan çështjet në vendbanimet joformale në vendet e tyre. Aplikimi i procedurave të qëndrueshme në rregullimin dhe planifikimin e buxhetit për rregullim ishin çështjet kryesore të ngritura nga delegacioni kosovar.

Takimi përfundoi me kërkesa specifike për shkëmbim informatash mes vendeve pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor dhe mobilizim madhor të resurseve. Shpresohet që ftesa e dytë për miratim të demo-projekteve do të bëhen para Takimit të 5-të Rajonal Shqyrtues që do të mbahet në Podgoricë, Mal të Zi, në maj 2007.

Suzana Goranci

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, MMPH

FERIZAJ TAKON LUNDIN

Komuna e Ferizajt është aktualisht në fazën e hartimit të PZHK-së (Planit Zhvillimor Komunal) dhe PZHU-së (Planin Zhvillimor Urban). Gjatë procesit të planifikimit, kemi identifikuar një problem me trafikun dhe transportin, dhe kemi inicuar një angazhim të frymës publike për të ndërtuar një pilot-projekt të "Qendrës së Mobilitetit". Kjo iniciativë, në parim, u përkrah edhe nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt.

Si pjesë e procesit të këtij pilot-projekti, një vizitë studimore në një qytet/shtet tjetër me lëvizshmëri të integruar e të suksesshme ishte planifikuar për të dhënë një shembull të mirë për Ferizajn, si dhe për të marrë ide të dobishme për implementimin e një qendre të tillë.

Nga 20 – 23 nëntor 2006, përfaqësuesit e komunës së Ferizajt, duke përfshirë Z. Faik Grainca (Kryetar Komune), Z. Dugagjin Etemi (KSHE), Z. Mustafe Zariqi (Shef i Sektorit të Planifikimit Urban) dhe tre përfaqësues nga "Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal" (MuSPP) nga UN-Habitat-i vizituan qytetin e Lundit në Suedi. Grupi u përcoll edhe nga një ekip televiziv nga RTK-ja.

Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte të shohim se si transporti publik (me autobus dhe tren) është i organizuar dhe si funksionon ai. Vizita në Lund nuk ishte e rastësishme. Lund ka përafërsisht të njëjtën madhësi dhe popullsi me Ferizajn, dhe dyja qytetet kanë karakteristikën specifike që hekurudha kalon përmes qytetit.

Vizita u organizua nga eksperti i transportit nga Programi i UN-HABITAT-it, Z. Gunnar Lagerqvist dhe Departamenti i Transportit të Komunës së Lundit. Grupit iu paraqit një pasqyrë e organizimit, menaxhimit dhe funksionimit të mobilitetit të integruar në qytet. Nga prezantimet e dhëna nga ekspertët e këtij departamenti si dhe vizitat në terren, kemi parë se si transporti i integruar ofron lëvizshmëri funksionale dhe të rrjedhshme për të gjithë.

Kështu, dëshiroj të shpreh falënderimin tim për UN-Habitat-in për organizimin e kësaj vizite të dobishme, e cila na bindi për rëndësinë e heku-



rudhës në qendrën e qytetit, të integruar me sistemet tjera të transportit publik. Ideja e projektit, e ashtuquajtur "Qendra e Mobilitetit", është kontribut i mirë për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Kështu, vizita jonë na shtyri të mendojmë seriozisht mbi qasjen tonë ndaj të njëjtit problem në komunën tonë, në përputhje me kushtet dhe buxhetin

tonë. Bashkëpunimi dhe inkurajimi nga sektori privat në këtë rast është shumë i rëndësishëm, dhe aktualisht, e vetmja zgjidhje në realizimin e projekteve madhore në komunën tonë.

Dugagjin Etemi

Kryeshef i Komunës së Ferizajt

REPUBLIKA E SLOVENISË MIRËPRET MUSPP-IN

Nga 7 e deri më 11 nëntor 2006, si pjesë e Programit të MuSPP-it, UN-HABITAT organizoi një vizitë studimore në Republikën e Sllovenisë, për një delegacion të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Departamenti dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor), Asociacionit të Komunave të Kosovës, përfaqësues zyrtarë të disa komunave, si KSHE-të, Drejtorët e Departamenteve të Urbanizmit dhe planerë hapësinorë, si dhe personeli i UN-HABITAT-it që punon në Komunitet e Gjilanit, Ferizajt, Gjakovës, Prizrenit, Pejës dhe Mitrovicës.

Delegacioni u takua me një numër aktorësh të ndryshëm të përfshirë në planifikim hapësinor dhe vizitoi projektet strategjike në terren.

Grupi u mirëprit nga Komunitet e Mariborit, Celjes dhe Velenjes, ku u udhëheq nga Drejtoritë Komunale të Urbanizmit, Agjencitë Rajonale Zhvillimore dhe nga zyrtarë tjerë të dizajnit urban, mobilitetit, kërkimeve mjedisore dhe zhvillimit teknologjik. Grupi gjithashtu u mirëprit nga Instituti i Planifikimit Urban në Lubjanë, ku u takua me përfaqësues nga Drejtorati i Urbanizmit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Energjisë, Asociacioni Slloven i Planifikimit Urban dhe Hapësinor, si dhe Këshilli Evropian i Planerëve Urbanë.

Vizitat e ndryshme në terren ilustruan faktin që pika fillestare në përmirësimin e kushteve të jetës në nivelin komunal – edhe me resurse të kufizuara dhe para financimit në dispozicion – përbëhet nga iniciativa për hartimin e një vizioni afatgjatë, bashkë me një numër të kufizuar projektesh strategjike afatshkurte.

Komunitet e vizituara janë shumë aktive në përgatitjen apo organizimin e konkurseve për projekte strategjike që integrojnë arkitekturën, hapësirën publike, mobilitetin dhe përmirësimin e rrjeteve të gjelbra, për të mobilizuar financimin privat apo institucional. Këto projekte janë kryesisht të orientuara drejt konvertimit të tokave dhe ndërtesave për të kufizuar rritjen



e qytetit, si dhe për të ruajtur mjediset e gjelbra dhe rurale.

Vizita studimore gjithashtu ilustroi rëndësinë e të pasur një vizion në nivelin rajonal, të përkrahur nga Agjencitë Rajonale Zhvillimore. ARZH-të përforcojnë bashkëpunimin mes niveleve komunale e shtetërore, si dhe ndihmojnë në lobimin për fonde nga BE, investitorët lokalë e të huaj. ARZH-të në Marivor dhe Celje janë kryesisht të përqendruara në industrinë e re teknologjike për të gjeneruar zhvillime inovative ekonomike.

Komunitet e vizituara sllovene, sidomos Velenje, theksuan arritjen e tyre me adaptimin e Sistemeve Informa-

tive Gjeografike (GIS) në menaxhimin e tyre hapësinorë, si dhe mbulueshmërinë e kostos në iniciativat lokale dhe rajonale.

Sipas pjesëmarrësve, vizita studimore ishte relevante dhe e suksesshme. I ka hapur sytë drejt planifikimit të qëndrueshëm hapësinor, në pajtim me standardet evropiane. Gjithashtu, ka forcuar rrjetin e bashkëpunimit mes aktorëve zyrtarë në planifikim mes dy vendeve, si dhe mes autoriteteve ekzekutive qendrore e komunale, si dhe planerëve në Kosovë.

Raporti i plotë me rekomandimet për veprimet në vijim mund të ofrohet sipas kërkesës

NDIJIMI I LARGËT DHE GIS-I MUND TË NDIHMOJNË KOMUNAT NË PUNËN E TYRE NË PLANIFIKIM

Një nga vështirësitë më madhore, të cilat ballafaqohen në përgatitjen e planeve të tyre zhvillimore komunale e urbane, është mungesa e të dhënave. Të dhënat mund të mblidhen

në shumë mënyra, por një nga ato është metoda e ndijimit të largët (remote sensing), p.sh. nga fotografitë e një zone të bëra nga aeroplani ose sateliti. Të dhënat e mbledhura në këtë

mënyrë mund të përpunohen mëtutje me anë të GIS-it dhe të ndihmojnë procesin e planifikimit. Numri i ardhshëm i Buletinit do të ketë më shumë informata mbi këtë temë.

BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

Për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët, Kosova ka nevojë për qytete më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm përmes planifikimit dhe punës së përbashkët. "Bashkë krijojmë qytete më të mira" është motoja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, financuar nga SIDA, përmes të cilit UN-HABITAT-i do të mbështesë planifikimin komunal hapësinor në Kosovë. Planet duhet të jenë strategjike dhe të orientuara në veprime, detaje në planet rregullative urbane dhe të zbatuara me investime private e publike. Gjashtë qytetet sekondare të Kosovës – Peja, Gjakova, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjilani – mund të kontribuojnë në një zhvillim më të drejtpeshuar të Kosovës dhe të zvogëlojnë migrimet e vazhdueshme të popullsisë drejt kryeqytetit, Prishtinës. Përmes integritit në rrjetin urban evropian, qytetet dhe qytetarët e Kosovës do të lidhen me qytete tjera evropiane. Kjo mund të arrihet duke tërhequr investimet në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke përmirësuar qasjen për të gjithë. Investimet private janë të nevojshme për t'u kombinuar me ato publike, drejt sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët: banim të përshtatshëm social, spitale, shkolla, transport publik, rrugë, si dhe përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, hapësirat atraktive publike për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie në ndryshim.

IMPRESSUM



Bashkë bëjmë qytete më të mira

**Programi i Mbështetjes
së Planifikimit Hapësinor
Komunal në Kosovë**

Krye-Këshillare Teknike, u.d.
Elisabeth Belpaire
office@unhabitat-kosovo.org

Zyra:
UN-HABITAT Kosovë
Rruga Nazim Gafurri,
nr.33, 10000
Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381/38/517835
Fax: +381/38/517836

**Informimi dhe komunikimi/
Marrëdhëniet Publike**

Lumnije Gashi
lumnije.gashi@unhabitat-kosovo.org

Më shumë informata mbi
UN-HABITAT-in / PMPHK:
www.unhabitat-kosovo.org

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes SIDA-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet i përkasin autorëve. Artikujt pa tregim autori janë pjesë e ekipit të MuSPP-it. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën dhe vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë: Qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklaratave të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e SIDA-s, apo Qeverisë së Suedisë.